

Ekonomia e eurozonës, sipas të dhënave preliminare, në tremujorin e tretë (TM3) 2018 është karakterizuar me një rritje të ngadalësuar të aktivitetit ekonomik (rreth 1.9 përqind) përderisa inflacioni ka arritur objektivin e BQE-së. Përkundër ngadalësimit të rritjes së aktivitetit ekonomik në eurozonë, vendet e Ballkanit Perëndimor janë karakterizuar me rritje të përshpejtuar të aktivitetit ekonomik (4.2 përqind në TM2 2018).

Sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në TM2 2018 shënoi rritje vjetore prej 4.7 përqind, rritje e mbështetur kryesisht nga rritja e konsumit dhe investimeve. Meqenëse të dhënat zyrtare për TM3 2018 nuk janë publikuar ende nga ASK-ja, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, rritja ekonomike në TM3 2018 kundrejt tremujorit paraprak pritet të jetë më e ulët, kryesisht si pasojë e zhvillimeve negative në sektorin e jashtëm (rënies së eksportit dhe rritjes së importit) por edhe ngadalësimit të rritjes së burimeve të financimit të konsumit.

Niveli i çmimeve të konsumit në ekonominë e vendit është rritur për 1.4 përqind në TM3 2018, pas ngadalësimit me të cilin u karakterizuan në gjysmën e parë të vitit 2018. Në anën tjetër, inflacioni bazë (që përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin), rezultoi në nivel prej 0.3 përqind apo 1.2 pikë përqindje më i ulët krahasuar me inflacionin e përgjithshëm, kryesisht si rezultat i rënies së çmimit të energjisë.

Sektori fiskal deri në shtator 2018 u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore prej 5.7 përqind përkatësisht 10.4 përqind. Përkundër faktit se norma e rritjes së shpenzimeve ishte më e lartë krahasuar me normën e rritjes së të hyrave, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 9.2 milionë euro (60.8 milionë euro suficit në periudhën e njëjtët të vitit 2017). Borxhi publik në TM3 2018 ka arritur në 1.08 miliardë euro, që është për 11.9 përqind më i lartë krahasuar me TM3 2017. Rritja e borxhit publik në Kosovë i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm përderisa borxhi i jashtëm publik u karakterizua me rënie. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.9 përqind nga 15.7 përqind sa ishte në TM3 2017.

Deri në gusht 2018, sektori i jashtëm është karakterizuar me rritje vjetore të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 40.3 përqind. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së deficitit të mallrave dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv të shërbimeve, përderisa bilancet pozitive të të ardhurave parësore dhe dytësore shënuan rritje. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat u karakterizuan me rritje prej 6.0 përqind përderisa Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan rënie prej 43.0 përqind.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE -----	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	03
Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare -----	05
Ekonomia e Kosovës -----	06
Sektori Real-----	06
Çmimet-----	08
Regjistri i bizneseve-----	09
Sektori Fiskal-----	10
Sektori i Jashtëm-----	11

FIGURAT DHE TABELAT

Figura 1. Zhvillimet makroekonomike në eurozonë -----	03
Figura 2. Normat kryesore të interesit në eurozonë-----	04
Figura 3. Çmimi i naftës 'Brent' -----	05
Figura 4. Çmimet e metaleve-----	06
Figura 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	06
Figura 6. Konsumi privat dhe burimet e financimit -----	07
Figura 7. Treguesit e tërthortë për investimet private-----	07
Figura 8. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë -----	08
Figura 9. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë -----	08
Figura 10. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit -----	09
Figura 11. Lëvizja e çmimeve të importit -----	09
Figura 12. Lëvizja e çmimeve të prodhimit -----	09
Figura 13. Regjistri i bizneseve -----	10
Figura 14. Struktura e ndërrmarrjeve të reja-----	10
Figura 15. Eksporti dhe importi i mallrave -----	12
Figura 16. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	12
Figura 17. Struktura e importeve sipas kategorive -----	12
Figura 18. Remitencat-----	13
Figura 19. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve -----	14
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së -----	04
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	16

SHKURTESAT:


APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Sipas të dhënave preliminare të Agjencisë Statistikore të Bashkimit Evropian (Eurostat), në TM3 2018 ekonomia e eurozonës shënoi rritje vjetore prej 1.9 përqind, që është një normë e rritjes më e ngadalësuar krahasuar me tremujorin paraprak (2.1 përqind në TM2 2018) si dhe tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (2.8 përqind në TM3 2017) (figura 1). Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik mund t'i atribuohet deri në një masë dobësimi të tregtisë ndërkombëtare (vetëm në muajin shtator 2018 kishte një rënie prej 1.0 përqind në eksportin e mallrave të eurozonës), ndikimit negativ të disa faktorëve të përkohshëm si kushtet e këqija atmosferike, por edhe ritmit të fortë të rritjes në vitin 2017. Pritjet për ecurinë e aktivitetit ekonomik në vazhdim janë optimiste, në përputhje me nivelet ende të larta të indekseve të besueshmërisë së bizneseve dhe të individëve. Sipas projeksioneve të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), eurozona pritet të shënojë rritje ekonomike prej 2.0 përqind në vitin 2018, rritje e cila pritet të ngadalësohet gradualisht në tre vitet e ardhshme (1.7 përqind në 2020). Qëndrueshmëria e rritjes ekonomike në eurozonë në periudhat në vazhdim mund të rrezikohet nga rritja e pasigurive rreth politikave tregtare, gjë që mund të ndikojë besueshmërinë e bizneseve dhe të individëve dhe të ketë pasoja negative në investime.


Përderisa fillimi i vitit 2018 u karakterizua me presione të dobëta inflacioniste, zhvillimet e përgjithshme të çmimeve në eurozonë në muajt në vazhdim kanë shfaqë tendencë rritjeje, ku shkalla e inflacionit arriti objektivin e BQE-së prej 2 përqind. Në TM3 2018, mesatarja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në eurozonë ishte 2.1 përqind,

(figura 1) kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimit.



Në tetor të vitit 2018, Këshilli Mbikëqyrës i BQE-së ka vendosur që programi mujor për blerjen e aseteve nga 30 miliardë euro të reduktohet në 15 miliardë euro dhe të vazhdoj deri në fund të vitit 2018 dhe më pas, varësisht nga zhvillimet në nivelin e çmimeve, programi të përmbillet. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës vendosi t'i mbajë të pandryshuar normën e interesit të operacioneve kryesore të rifinancimit (0.0 përqind), normën e interesit mbi lehtësirat kreditore (0.25 përqind) dhe depozitare (-0.40 përqind). BQE-ja pritet të vazhdojë të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të rifinancimit të pandryshuar edhe pas përfundimit të programit të lehtësimit sasior. Normat e kreditimit ndër-bankar Euribor 1 mujor dhe 12 mujor vazhdojnë të jenë në territor negativ (-0.37 përqind përkatësisht -0.17 përqind), ndërsa yield-i i obligacioneve qeveritare dhjetëvjeçare të eurozonës ka shënuar një rritje të lehtë gjatë TM3 2018, duke arritur në 1.32 përqind (figura 2).

Figura 2. Normat kryesore të interesit në eurozonë



Burimi: BQE (2018)

Aktiviteti kreditues në eurozonë ka shënuar përmirësim të lehtë në TM3 2018. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së kredive akorduar ndërmarrjeve por edhe ekonomive familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 4.3 përqind ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.1 përqind. Ngjashëm me ecurinë e kreditimit janë zhvilluar edhe dinamikat e depozitave në sistemin bankar. Në TM3 2018, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 4.5 përqind ndërsa depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje prej 4.6 përqind.

Aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë TM2 2018¹ ka shënuar rritje vjetore prej mesatarisht 4.2 përqind (2.5 përqind në TM2 2017). Mali i Zi, Serbia, dhe Kosova shënuan rritje më të lartë, pasuar nga Shqipëria, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia (tabela 1).

Përmirësimi i aktivitetit ekonomik në këto vende është udhëhequr kryesisht nga performanca e mirë e sektorit të ndërtimit, tregtisë dhe industrisë.

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2016	2017	2017 TM1	2017 TM2	2017 TM3	2017 TM4	2018 TM1	2018 TM2
Bosnja dhe Hercegovina	3.4	3.4	-3.0	0.9	10.5	2.5	2.0	3.4
Kosova	4.1	4.2	2.8	4.4	4.4	3.2	3.5	4.7
Mali i Zi	2.9	4.2	2.9	5.0	4.8	3.9	4.5	4.9
Maqedonia	2.9	0.0	0.0	-1.3	1.5	1.0	-1.1	3.0
Serbia	2.8	1.9	1.1	1.6	2.3	2.4	4.9	4.8
Shqipëria	3.4	3.8	3.9	4.3	3.5	3.6	4.5	4.3

Burimi: Zyrat Kombëtare Statistikore të vendeve përkatëse

Në TM3 2018, inflacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor ka shënuar normë mesatare prej 1.4 përqind (2.0 përqind në TM3 2017). Presione më të dobëta inflacioniste ishin prezentë në Maqedoni (-0.4 përqind), Bosnje e Hercegovinë (0.4 përqind) dhe Kosovë (1.4 përqind), ndërsa në vendet tjera normat e inflacionit ishin më të larta. Në Mal të Zi norma mesatare e inflacionit ishte 2.4 përqind për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë dhe të një sërë tatimesh në kuadër të rregullimit fiskal. Në Shqipëri, inflacioni mesatar në TM3 2018 shënoi vlerën prej 2.2 përqind (1.7 përqind në TM3 2017), ku presionet e brendshme mbi shkallën e inflacionit janë balancuar nga mbiçmimi i fortë i kursit të këmbimit.

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, rritja e kredive dhe depozitave ishte e konsiderueshme dhe me diferenca të theksuara ndërmjet vendeve. Deri në shtator të vitit 2018 norma mesatare e rritjes së kredive ishte 6.5 përqind (4.9 përqind deri në shtator 2017). Vendet të cilat shënuan rritje më të lartë kreditimit ishin Kosova dhe Mali i Zi (11.4 përqind përkatësisht 10.7 përqind) ndërsa Serbia dhe Shqipëria shënuan rritje më të ulët gjegjësisht rënie (6.3 përqind përkatësisht -3.3 përqind). Depozitat shënuan normë edhe më të lartë të rritjes krahasuar me kreditë. Deri në shtator 2018, norma mesatare e

¹ Të dhënat për TM3 2018 nuk janë publikuar ende.

rritjes së depozitave ishte 7.2 përqind. Tek depozitat, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Maqedoni me 10.6 përqind, pasuar nga Mali i Zi me 10.3 përqind, Bosnja e Hercegovina me 10.0 përqind, etj.

Gjatë TM3 2018, euro është vlerësuar ndaj lirës turke me 60.0 përqind dhe frankës zvicerane me 1.2 përqind, ndërsa ndaj lekut shqiptar dhe dinarit serb, monedha euro është zhvlerësuar me rreth 5.2 përqind dhe 1.3 përqind, respektivisht.


Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Gjatë TM3 2018, çmimet e mallrave u goditën nga ngjarjet gjeopolitike dhe zhvillimet makroekonomike të cilat ndikuan në ndryshimin e dinamikave të ofertës dhe kërkesës në treg.

Çmimet e energjisë shënuan rritje prej 3.4 përqind krahasuar me tremujorin paraprak ndërsa krahasuar me TM3 2017 rritja ishte shumë e lartë (41.5 përqind), kryesisht si përgjigje ndaj rivendosi së sanksioneve ndaj Iranit nga Shtetet e Bashkuara dhe rënies së vazhdueshme të prodhimit në Venezuelë. Çmimi i naftës së papërpunuar shënoi rritje prej 1.3 përqind krahasuar me tremujorin paraprak e rritje prej 45.9 përqind krahasuar TM3 2017. Çmimi i naftës *Brent* shënoi vlerën mesatare prej 75.5 dollarë për fuçi në TM3 2018 (51.7 dollarë për fuçi në TM3 2017). Në këtë rritje të çmimit të naftës ndikuan një sërë faktorësh, të cilët kanë rrezikuar eksportin e tij: zvogëlimi i stoqeve si rezultat i rritjes së kërkesës botërore, marrëveshja e vendeve të OPEC-ut për të reduktuar ofertën e naftës, tensionet gjeopolitike në vendet e Lindjes së Mesme, etj. Çmimet e naftës së papërpunuar pritet të luhaten mesatarisht rreth vlerës 72 dollarë për fuçi në vitin 2018 dhe 74 dollarë për fuçi në vitin 2019. Megjithatë,

ecuria e çmimeve të naftës në të ardhmen varet në mënyrë të konsiderueshme nga balanca ndërmjet prodhimit të naftës në SHBA dhe vazhdimësisë në uljen e prodhimit të naftës nga OPEC-u (figura 3).


Figura 3. Çmimi i naftës 'Brent'



Burimi: Banka Botërore (2018)

Në anën tjetër, çmimet e metaleve dhe mineraleve shënuan rënie prej 1.8 përqind krahasuar me TM3 2017, ndërsa krahasuar me tremujorin paraprak shënuan rënie prej 9.6 përqind (figura 4). Kjo rënie e çmimeve të metaleve erdhi si rezultat i zbutjes së kërkesës globale, forcimit të dollarit amerikan dhe rritjes së tensioneve tregtare midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës. Përkundër rënies në TM3, çmimet e metaleve pritet të mbesin më të larta në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 si rezultat i rritjes së theksuar të çmimeve në gjysmën e parë të vitit 2018, ndërsa për vitin 2019 pritet të mbesin të pandryshuara. Në të ardhmen ekonomia e Kinës do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në tregjet globale të metaleve, duke qenë se përbën rreth 50% të konsumit të metaleve në nivel global. Kina pritet të reformojë sektorin e minierave dhe të përpunimit dhe të orientohet drejt një ekonomie të bazuar në konsum, gjë e cila do të ndikojë në rritje më të ngadaltë të kërkesës për metale.

Figura 4. Çmimet e Metaleve



Burimi: Banka Botërore (2018)

Edhe çmimi i arit ka shënuar rënie vjetore prej rreth 5.1 përqind në TM3 2018, duke regjistruar vlerën 1,212.6 dollarë për ons. Kjo rënie i atribuohet zvogëlimit të kërkesës për investim në kushtet e forcimit të dollarit amerikan dhe shtrëngimit të politikës monetare të disa prej ekonomive të zhvilluara, gjë që ka ulur atraktivitetin e arit si aset investues.


Në TM3 2018, indeksi i çmimeve të ushqimit mbeti pothuajse i pandryshuar krahasuar me TM3 2017, si rezultat i mbjelljeve të reduktuara të misrit dhe prodhimit të kufizuar në Amerikën Jugore për shkak të kushteve klimatike. Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim, çmimet e ushqimeve priten të stabilizohen, me një tendencë të lehtë rritëse si pasojë e shtrëngimit së ofertës së tyre.

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në gjysmën e parë të vitit 2018 shënoi rritje vjetore prej 4.2 përqind. Vetëm në TM2 2018, rritja reale e BPV-së ishte 4.7 përqind. Kontributi kryesor në këtë rritje ka ardhur nga konsumi me 4.5 pikë përqindje dhe investimet me 4.2 pikë përqindje. Në anë tjetër, eksportet neto, si pasojë e rritjes së theksuar të importit, kanë ndikuar negativisht në rritjen e BPV-së me 4.0 pikë përqindje (figura 5).

Figura 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK (2018) dhe llogaritjet e BQK -së

Konsumi privat ka kontribuar me 3.8 pikë përqindje (-2.2 pikë përqindje në TM2 2017). Ky kontribut pozitiv mbështetet nga zhvillimet pozitive që janë regjistruar në burimet kryesore të financimit të konsumit privat. Kredia e re për konsum, remitencat dhe kompensimi i punëtorëve kanë përsheptuar trendin e rritjes, duke shënuar rritje vjetore prej 16.8, 9.0 përkatësisht 3.5 përqind në TM2 2018. Tregues tjetër i rritjes së konsumit privat në TM2 2018 është edhe rritja e importit të mallrave të konsumit i cili shënoi rritje prej 5.8 përqind (3.2 përqind në TM2 2017) (figura 6).


Përveç konsumit privat edhe konsumi publik, si rezultat i rritjes së shpenzimeve rrjedhëse prej 7.2 përqind, kontribuoi pozitivisht në rritjen e BPV-së reale (0.6 pikë përqindje).

përqindje secila), ndërtimtaria (0.5 pikë përqindje), etj. Ndërsa, furnizimi me energji elektrike shënoi kontribut negativ (0.2 pikë përqindje) në rritjen e BPV-së reale.

Edhe pse të dhënat zyrtare nga ASK-ja për BPV-në reale në TM3 2018 nuk janë publikuar ende, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, rritja ekonomike në këtë tremujor kundrejt tremujorit paraprak pritet të jetë më e ulët, kryesisht si rezultat i zhvillimeve negative në sektorin e jashtëm (rënies së eksportit dhe rritjes së importit) por edhe ngadalësimit të rritjes së burimeve të financimit të konsumit.

Në bazë të trendeve aktuale, eksportet neto pritet të përkeqësohen në TM3 2018. Eksporti i mallrave ka shënuar rënie prej 8.7 përqind ndërsa importi i mallrave është rritur për 10.9 përqind. Edhe eksporti i shërbimeve në muajt korrik-gusht 2018 ka shënuar rënie prej 3.4 përqind ndërsa importi i shërbimeve është rritur për 7.6 përqind. Sa i përket konsumit, pritet një rritje më e ngadalësuar krahasuar me tremujorin paraprak. Kredia e re për konsum ka shënuar rënie prej 6.9 përqind ndërsa remitencat shënuan rritje të ngadalësuar prej 3.7 përqind në muajt korrik-gusht 2018. Sinjal tjetër i pritjeve për një rritje më të ngadalësuar të konsumit privat është edhe ngadalësimi i rritjes së importit të mallrave të konsumit prej 3.4 përqind (5.8 përqind në tremujorin paraprak). Në anën tjetër, shpenzimet rrjedhëse të qeverisë të cilat shënuan rritje prej 11.8 përqind pritet të zbusin efektet negative të ngadalësimit të konsumit privat në konsumin e përgjithshëm. Treguesit e tërthortë për investimet private ofrojnë sinjale pozitive në TM3 2018. Importi i mallrave kapitale si


Figura 6. Konsumi privat dhe burimet e financimit



Burimi: ASK (2018) dhe llogaritje të BQK-së

Kontributi pozitiv i investimeve totale i atribuohet kryesisht rritjes së kredive për investime prej 28.7 përqind në TM2 2018, ndërkohë që edhe importi i mallrave kapitale shënoi rritje prej 24.8 përqind (figura 7).

Figura 7. Treguesit e tërthortë për investimet private



Burimi: ASK (2018) dhe llogaritje të BQK-së

Sipas metodës së prodhimit, kontributin më të madh në rritjen e BPV-së reale në TM2 2018 e kishin aktivitetet financiare dhe të sigurimit (0.9 pikë përqindje), tregtia dhe administrimi publik (0.6 pikë


dhe kreditë e reja për investime kanë shënuar rritje prej 25.1 përqind përkatësisht 6.4 përqind. Gjithashtu, numri i bizneseve të reja, korigjuar me numrin e bizneseve të mbyllura, ka regjistruar rritje prej 10.7 përqind në TM3 2018.

Sipas projeksioneve të BQK-së, aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2018 do të shënojë një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2017, duke arritur normën prej 4.3 përqind (4.2 përqind në vitin 2017). Ky përmirësim i lehtë i atribuohet kryesisht stimulit të përforcuar fiskal si dhe rritjes së kreditimit dhe remitencave gjatë vitit 2018, të cilat pritet të vazhdojnë të jenë burime të qëndrueshme për financimin e aktivitetit ekonomik.

Çmimet

Indeksi i çmimeve të konsumit deri në shtator 2018 ka arritur normën mesatare prej 0.7 përqind. Gjysma e parë e vitit 2018 është karakterizuar me një rritje të ngadalësuar prej 0.3 përqind ndërsa në TM3 2018 norma e inflacionit ishte më e lartë (1.4 përqind) (figura 8).

Figura 8. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2018)

Sa i përket komponentëve të IÇK-së, gjatë TM3 2018, me rritje u karakterizuan çmimet e transportit (5.3 përqind), pasuar nga çmimet e restoranteve dhe

hoteleve (2.8 përqind), çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (2.5 përqind), çmimet e ushqimit dhe pijeve jo-alkoolike (2.0 përqind), etj. Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar tek çmimet e rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse (6.9 përqind), çmimet rekreacionit dhe kulturës (1.6 përqind), çmimet e mjeteve të komunikimit (1.3 përqind), çmimet e veshmbathjes (1.3 përqind), etj. (figura 9).

Figura 9. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2018)

Meqenëse shporta e konsumatorit kosovarë karakterizohet me pjesëmarrje shumë të lartë të produkteve me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqimi, energjia, pijet alkoolike dhe duhani), atëherë edhe inflacioni bazë, i cili përjashton këto komponente, është më stabil (figura 8). Një gjë e tillë është vërejtur edhe në TM3 2018 ku inflacioni bazë prej 0.3 përqind ishte për 1.2 pikë përqindje më i ulët se sa inflacioni i përgjithshëm.

Si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi, dinamika e lëvizjes së çmimeve në Kosovë ndikohet në masë të madhe edhe nga lëvizja e çmimeve të importit. Indeksi i çmimeve të importit deri në qershor 2018 shënoi rritje prej 0.9 përqind (figura 10).


Figura 10. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2018)

Në TM2 2018, çmimet e produkteve minerale dhe metaleve bazë, të cilat janë kategoritë kryesore të indeksit të çmimeve të importit, shënuan rritjen më të lartë (16.7 përqind përkatësisht 6.2 përqind), ndërsa çmimet e letrës dhe artikujve të saj si dhe çmimet e produkteve bimore shënuan rënien më të lartë (6.6 përqind përkatësisht 1.7 përqind) (figura 11).


Figura 11. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2018)

Indeksi i çmimeve të prodhimit deri në qershor 2018 u karakterizua me rritje vjetore prej 2.0 përqind.

Figura 12. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2018)

Vetëm në TM2 2018, rritjen më të lartë të çmimeve e shënuan prodhimi i metaleve dhe prodhimi i drurit (26.0 përqind përkatësisht 6.8 përqind), ndërsa me rënie të çmimeve u karakterizuan energjia elektrike, prodhimi i mobileve, nxjerrja e xehes së metalit (1.5 përqind, 0.6 përqind, përkatësisht 0.3 përqind) (figura 12).

Regjistri i Bizneseve

Tregues i rëndësishëm i zhvillimeve në sektorin real është edhe numri i bizneseve të reja të regjistruara. Për dallim nga viti 2017 që ishte karakterizuar numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara, deri në shtator të vitit 2018 janë regjistruar 7,404 ndërmarrje të reja apo 1.4 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Gjithashtu, edhe numri i ndërmarrjeve të mbyllura ishte më i vogël, 982 sosh apo 17.5 përqind më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Vetëm në TM3 2018 janë regjistruar 2,212 ndërmarrje të reja që është nivel i njëjtë me TM3 2017 ndërsa janë mbyllur 93 ndërmarrje apo 69.1 përqind më pak krahasuar me TM3 2017 (figura 13).


Figura 13. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2018)

Aktiviteti ekonomik më i preferuar vazhdon të jenë sektori i tregtisë ku u regjistruan 1,964 ndërmarrje të reja deri në shtator 2018 apo 0.7 përqind më shumë. Është inkurajuese rritja e numrit të ndërmarrjeve tek sektori i prodhimit dhe ai i informacionit dhe komunikimit. Në sektorin e prodhimit u regjistruan 829 ndërmarrje të reja apo 14.5 përqind më shumë ndërsa në sektorin e informacionit dhe komunikimit u regjistruan 377 ndërmarrje të reja apo 12.9 përqind më shumë.

Figura 14. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2018)

Rritje e konsiderueshme e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara është shënuar edhe në sektorin e ndërtimtarisë me 715 ndërmarrje apo 8.5 përqind më shumë, etj. (figura 14).

Sektori Fiskal

Deri në shtator 2018, sektori fiskal u karakterizua me performancës të mirë të të hyrave buxhetore dhe rritje të shpenzimeve buxhetore. Përkundër faktit se norma e rritjes së shpenzimeve ishte më e lartë krahasuar me normën e rritjes së të hyrave, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 9.2 milionë euro (60.8 milionë euro suficit në periudhën e njëjtët të vitit 2017).

Të hyrat buxhetore² arritën vlerën prej 1.30 miliardë euro apo 5.7 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja e arkëtimit të të hyrave buxhetore erdhi si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik por edhe reformave të ndërmarra nga agjencitë e të hyrave që kanë për synim ngushtimin e hendekut tatimor. Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arkëtohen nga tatimet në të ardhura dhe pasuri. Këto të hyra shënuan rritje prej 15.7 përqind dhe arritën vlerën 207.6 milionë euro. Me rritje u karakterizuan edhe të hyrat tatimore indirekte të cilat janë të ndërlidhura me lëvizjen e importit i cili ka shënuar rritje të konsiderueshme. Të hyrat indirektet arritën vlerën prej 991.3 milionë euro (3.9 përqind rritje). Në anën tjetër, të hyrat jo-tatimore, që kryesisht janë të hyra nga organizatat buxhetore,

² Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

shënuar rënie prej 1.2 përqind dhe arritën vlerën 136.8 milionë euro.

Ndërkaq, sa i përket shpenzimeve buxhetore³, ato arritën vlerën prej 1.29 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore prej 10.4 përqind. Gjatë kësaj periudhe të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore u karakterizuan me rritje. Norma më e lartë e rritjes është shënuar tek shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe komunalitë) të cilat arritën vlerën prej 158.1 milionë apo 15.3 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Subvencionet dhe transferet të cilat arritën vlerën prej 401.5 milionë euro ishin për 15.0 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Kategoria e pagave që përbën kategorinë kryesore të shpenzimeve buxhetore (34.1 përqind e gjithsej shpenzimeve), shënoi rritje prej 7.1 përqind dhe arriti vlerën 439.3 milionë euro. Sa i përket shpenzimeve kapitale, është vërejtur një ngadalësim i rritjes. Deri në shtator 2018, shpenzimet kapitale shënuan rritje prej 6.2 përqind dhe arritën vlerën prej 297.2 milionë euro (18.6 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit 2017), ndërsa u realizuan vetëm 42.8 përqind e shpenzimeve kapitale të buxhetuara për vitin 2018 (55.9 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2017).

Borxhi publik, në TM3 2018, ka arritur në 1.08 miliardë euro që është për 11.9 përqind më i lartë krahasuar me TM3 2017. Rritja e borxhit publik në Kosovë i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm publik prej 23.0 përqind (i cili ka arritur në 663.5 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka shënuar rënie prej 2.2 përqind dhe ka arritur në 416.6

milionë euro. Pra, pjesa më e madhe e borxhit publik (61.4 përqind) është borxh i brendshëm, që kryesisht përbëhet nga borxhi i Qeverisë së Kosovës ndaj bankave komerciale (38 përqind), fondeve pensionale (29 përqind), etj. Pjesa tjetër e borxhit publik (38.6 përqind) është borxh i jashtëm, që kryesisht i përket Fondi Monetar Ndërkombëtar me 39 përqind, Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim me 35 përqind, Agjencisë Gjermane për Rindërtim me 12 përqind, etj.

Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.9 përqind nga 15.7 përqind sa ishte në TM3 2017. Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit është ende larg pragut prej 40 përqind të paraparë me ligj. Për më tepër, ky nivel i borxhit publik e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit, të cilat sipas FMN-së, kanë një mesatare të borxhit publik prej 59.1 përqind.

Sektori i Jashtëm


Deri në gusht 2018, sektori i jashtëm është karakterizuar me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 40.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së deficitit të mallrave dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv të shërbimeve, përderisa bilancet pozitive të të ardhurave parësore dhe dytësore shënuan rritje.

Deficiti në llogarinë e mallrave shënoi vlerën prej 814.1 milionë euro në TM3 2018, që paraqet një rritje vjetore

³ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

prej 13.8 përqind. Përderisa në vitin 2017 ishte shënuar rritje e theksuar e eksportit të mallrave, viti 2018 është duke u shoqëruar me rënie të eksportit të mallrave dhe përshpejtim të rritjes së importit. Kjo ka ndikuar që shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte të ulët në 10.5 përqind në TM3 2018 nga 12.8 përqind sa ishte në TM3 2017.

Figura 15. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro




Burimi: ASK (2018)

Në TM3 2018 eksportit i mallrave ka shënuar vlerën prej 95.9 milionë euro që është për 8.7 përqind më pak krahasuar me TM3 2017 (figura 15).⁴ Kjo rënie e eksportit të mallrave ishte për shkak të ngadalësimit të rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare por edhe për shkak të stabilizimit të kërkesës së jashtme krahasuar me vitin 2017.

Rënia e eksportit të mallrave gjatë këtij tremujori ishte më e theksuar tek produktet minerale, metalet bazë si dhe lëkura dhe artikujt e saj. Në anën tjetër, rritje të lehtë shënoi eksporti i produkteve të plastikës dhe gomës, eksporti i artikujve ushqimorë, eksporti i makinerive dhe materialeve elektrike, etj. (figura 16).


Figura 16. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2018)

Si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme në vend, me rritje të konsiderueshme është karakterizuar importi i mallrave. Vlera e importit të mallrave në TM3 2018 ishte 910.1 milionë euro, që është për 10.9 përqind më shumë krahasuar me TM3 2017. Rritje e importit të mallrave u shënuar pothuajse tek të gjitha kategoritë, mirëpo rritja më e lartë u shënuar tek importi i produkteve minerale, metaleve bazë, makinerive dhe materialeve elektrike, etj. (figura 17).

Figura 17. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2018)

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 690.8 milionë euro deri në gusht 2018, një rënie prej


⁴ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

1.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoi rritje vjetore prej 4.6 përqind, duke arritur në 1.1 miliardë euro, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara shënoi rritje prej 16.4 përqind dhe arriti në 417.0 milionë euro.

Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet tjera të biznesit shënuan rritjen më të lartë prej 45.4 përqind, ndërsa shërbimet e udhëtimit, që përbëjnë kategorinë kryesore të eksportit (82.5 përqind), shënuan rritje prej vetëm 1.0 përqind. Edhe tek importi i shërbimeve, shërbimet tjera të biznesit shënuan rritjen më të lartë, pasuar nga shërbimet pensionale dhe të sigurimit, ndërsa shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit shënuan rënie.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore, deri në gusht 2018, shënoi vlerën prej 89.4 milionë euro (26.9 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017). Bilanci i të ardhurave nga kompenzimi i punonjësve⁵ shënoi rritje për 8.4 përqind, ndërsa bilanci i të ardhurave nga investimet u zvogëlua për 44.2 përqind. Në të njëjtën periudhë, bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 11.6 përqind, që i atribuohet kryesisht nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore arritën vlerën prej 520.3 milionë euro dhe shënuan një rritje vjetore prej 6.0 përqind (figura 18).

Figura 18. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Remitencat që pranohen në Kosovë kryesisht vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 41.1 përkatësisht 20.5 përqind e gjithsej remitencave. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 6.5 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.


Llogaria financiare deri në gusht 2018 shënoi bilanc prej -77.9 milionë euro (-122.9 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017).

Detyrimet por edhe asetet shënuan nivel dukshëm më të ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Detyrimet shënuan vlerën prej 222.1 milionë euro (381.8 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017) ndërsa asetet shënuan vlerën prej 144.2 milionë euro (258.9 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017).

⁵ Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët

tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendren e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

Figura 19. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Në kuadër të detyrimeve, kategori kryesore është ajo e IHD-ve, e cila arriti vlerën prej 121.9 milionë euro dhe shënuan rënie vjetore prej 43.0 përqind. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti vlerën prej 119.9 milionë euro dhe shënoi rënie prej 38.6 përqind, ndërsa IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerë prej 2.0 milionë euro (18.6 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017) (figura 19).

Rënia më lartë e IHD-ve u shënuar në sektorin e ndërtimitarisë dhe të shërbimeve financiare përderisa në patundshmëri dhe në sektorin e tregtisë u shënuar rritje e IHD-ve (17.7 përkatësisht 38.7 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar). Sa i përket origjinës së IHD-ve, Zvicra paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD deri në gusht 2018 (47.1 milionë euro), pasuar nga Gjermania me 29.5 milionë euro, Shqipëria me 18.8 milionë euro, etj.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2018): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 24 TM3 2018, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2018):

- a) Buletini Mujo Statistiko: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2018):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistiko mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistiko-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2018): Metal Prices database.

FAOUN (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2018): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2018): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	TM3 2017	TM3 2018
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	-	-
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	1.7%	1.4%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	1.7%	1.5%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	474.9	497.6
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	416.9	461.3
Bilanci primar (në milionë euro)	58.0	36.3
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,765.2	6,226.2
prej të cilave: Bankat	3,811.4	4,033.3
Kredi	2,407.2	2,681.1
Depozita	3,046.9	3,210.1
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.5%	7.0%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	0.9%	1.4%
Hendeku i normës së interesit	5.6%	5.6%
Sektori i jashtëm*, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	295.6	250.7
prej të cilave: remitencat e pranuar	131.0	135.8
Llogaria financiare	142.1	122.2
Investimet e huaj direkte në Kosovë	64.8	42.0
Investimet portfolio, net	60.3	-91.5
Investimet tjera, net	17.6	27.1
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net	-182.5	-261.7
Asetet	4,664.3	4,754.4
Detyrimet	4,846.8	5,016.1
Borxhi i jashtëm, gjithsej	2,113.8	2,058.3
Borxhi i jashtëm privat	1,597.3	1,561.7
Borxhi i jashtëm publik	516.5	496.7

Burimi:

1/ ASK (2018).

2/ MF (2018).

3/ BQK (2018).

*Të dhënat për bilancin e pagesave përfshijnë muajt korrik dhe gusht ndërsa për PNI dhe borxh të jashtëm TM2

